

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ FRUTIBEST ” SH.P.K**

Ne baze te ligjit nr.7512 date 10.08.1991, te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe ne baze te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 zoti Murat Halili i biri Musait, lindur me 03.11.1963 ne Elbasan dhe banues ne qytetin e Elbasanit , lagjia “Kongresi i Elbasanit”, themelon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.) te emertuar “ FRUTIBEST “ sh.p.k.

**N E N I 1**

Shoqeria e ka emrin “FRUTIBEST” sh.p.k me ortak te vetem te saj z.Murat Halili. Organi drejtues i shoqerise “FRUTIBEST” sh.p.k eshte ortaku dhe administratori i saj. Admistrator i shoqerise eshte ortaku i vetem i saj z.Murat Halili.

**N E N I 2**

Shoqeria “FRUTIBEST” sh.p.k gezon statusin e personit juridik.Veprimtaria ekonomike dhe financiare e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te ketij akt themelimi, statutit te saj dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.Statuti i Shoqerise i bashkengjitet ketij akt themelimi dhe eshte pjese perberese e saj dhe e dokumentacionit te shoqerise.

**N E N I 3**

Shoqeria “FRUTIBEST” sh.p.k eshte person juridik dhe fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne organet perkatese.Shoqeria e ushtron veprimtarine saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj,akti i themelimit dhe ne statutin e saj.

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete akt, nese ortaku i vetem i saj me vullnetin e tij te lire nuk e zgjat kete afat.

**N E N I 5**


Selia e shoqerise “FRUTIBEST” sh.p.k eshte ne qytetin e Elbasanit, ne lagjen “ Brigada 17 Sulmuese”, Prane Markates se Qytetit.

Shoqeria mund te hape filiale ,dege, perfaqesi ose agjensi ne varesi te saj net e gjithë teritorin e Republikes se Shqiperise ne cdo kohe qe te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kopetente.

**N E N I 6**

Per te bere te mundur zhvillimin e shoqerise prej themeluesit te saj caktohet nje kapital themeltar prej 100.000(njeqindmije) leke i formuar teresisht nga ortaku i vetem i saj. Ky kapital eshte i depozituar ne Banke.

Ortaku i vetem i shoqerise mund te rrise kapitalin e shoqerise dhe ta pasqyroje ate ne regjistrin tregetar.



N E N I 7

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ekonomike:

“IMPORT-EKSPORT e Tregtim me shumice dhe me pakice te te gjithë mallrave industriale, ushqimore, blegtorale dhe bujqesore, fruta-perimeve. Tregtim te materialeve ndertimore, te pleherave kimike, paisjeve elektrike dhe elektronike, paisjeve elektroshtepijake. Grumbullimi dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore. Transport te mallrave dhe udhetareve. Zhvillim te aktivitetit tregtar ne bare e restorante”.

N E N I 8


Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise, sipas legjislacionin shqiptar , aktin e themelimit per krijimin e shoqerise dhe statutin e shoqerise.

N E N I 9

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne Statutin e saj. Ky akt themelimi perpilohet ne pese kopje te njejta origjinale per t’iu shperndare organeve kompetente ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te shoqerise.

ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETEM  
I SHOQERISE “FRUTIBEST” SH.P.K.

Murat Halili



Elbasan me 05.01.2004

REPUBLIKA SHQIPERISE  
DHOMA NOTEREVE ELBASAN

Nr. 57 rep.

TAKSA E PULLFS  
U LIKUJDUA

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Elbasan sot me date 05.01.2004 ne zyren e noterise, para meje noteres Majlinda Lato, me seli prane Gjykates se rrethit Elbasan, u paraqit personalisht shtetasi shqiptar z. Murat Halili i biri i Musait, lindur me 03.12.1963 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike, i njohur nga une noteria ne baze te pasaportes qe me paraqiti me nr. Z0343982 te leshuar date 07.12.2002, i cili aktin e mesiperm e nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire ne pranine time noteres dhe se fundi u vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit dhe konform tij.

NOTERE  
MAJLINDA LATO



**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" FRUTIBEST " SH.P.K**

**KREU I**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 1**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " FRUTIBEST " sh.p.k eshte krijuar sipas aktit te themelimit dhe ketij statuti te perpiluar dhe te nenshkruar nga ortaku i vetem i saj:z.Murat Halili i biri Musait, lindur me 03.12.1963 ne Elbasan dhe banues ne qytetin e Elbasanit, lagjia " Kongresi i Elbasanit".

**NENI 2**

Emertimi i shoqerise eshte "FRUTIBEST" sh.p.k(shoqeri me pergjegjesi te kufizuar).

**NENI 3**

Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

**NENI 4**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "FRUTIBEST" sh.p.k ne perputhje me vendimin per krijimin e kesaj shoqerie dhe me legjislacionin shqiptar,rregullon poziten juridike te themeluesit te saj dhe punonjesve ne shoqeri,te dhenat me rendesi per qarkullim juridik,organizimin,objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise dhe veprimtarine e saj.

**NENI 5**

Shoqeria "FRUTIBEST " sh.p.k eshte person juridik dhe fiton personalitet juridik qe nga data e regjistrimit ne organet perkatese.Shoqeria e ushtron veprimtarine saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj,akti i themelimit dhe ne kete statut.

**NENI 6**

Selia e shoqerise "FRUTIBEST "sh.p.k eshte ne qytetin e Elbasanit,lagjia "Brigada 17 Sulmuese ", Prane Markates se Qytetit.

**NENI 7**


Administratori i shoqerise eshte ortaku i vetem i saj z.Murat Halili.

**NENI 8**

Shoqeria ka vulen dhe stemen e saj me emerin e shoqerise.

**NENI 9**

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ekonomike:  
"IMPORT-EKSPORT e Tregtim me shumice dhe me pakice te te gjitha mallrave industriale, ushqimore, blegtorale dhe bujqesore, fruta-perimeve. Tregtim te



materialeve ndertimore, te pleherave kimike, paisjeve elektrike dhe elektronike, paisjeve elektroshtepijake. Grumbullimi dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore. Transport te mallrave dhe udhetareve. Zhvillim te aktivitetit tregtar ne bare e restorante”.

#### NENI 10

Shoqeria e ushtron veprimtarine e vet te percaktuar ne kete statut ne territorin e Republikes se Shqiperise. Per kryerjen e kesaj veprimtarie dhe zgjerimin e saj shoqeria mund te cele dege ,zyre dhe filiale te saj te perfaqesimit ne te gjithë territorin e vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### NENI 11

Shoqeria e kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit

#### NENI 12

Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon themeluesin e saj te kete pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

#### NENI 13

Organi drejtues i shoqerise eshte ortakut dhe administratori i vetem i saj.

Ortakut i vetem i shoqerise ka keto te drejta kryesore:

-Te marre pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesit te caktuar prej tij.

-Te marre pjese ne rezultatet e veprimtarise ne cdo forme e sasi qofte, ne perputhje me statutin dhe aktin e themelimit.

-Te marre pjese ne organet e shoqerise qe jane ose qe mund te krijohen nepermjet perfaqesuesit te tij ose vete.

-Te kerkoje ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise si dhe te gjithë dokumentat e perpunuara te shoqerise si bilancet ,llogarite ekonomike etj.

-Te beje propozime dhe ti paraqese ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.

-Te emerroje dhe te shkarkoje administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

-Te heqe dore nga shoqeria duke i ofruar pjese te saj te treteve. Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun e vetem nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj te treteve.

#### NENI 14

Themeluesi ka keto detyra kryesore:

-Te depozitoje kapitalin e tij ne perputhje me aktin e themelimit te shoqerise dhe me kete statut.

-Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektiveve te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

## KREU II

### KUSHTET EKONOMIKE

#### NENI 15

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te veprimtarise kontabel dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

#### NENI 16

Per te bere te mundur zhvillimin e shoqerise prej themeluesit te saj caktohet nje kapital themeltar prej 100.000(njeqindmije) leke i formuar teresisht nga ortakut i vetem i saj.

Ky kapital themeltar eshte i depozituar ne Banke.

#### NENI 17

Ortakut i vetem i shoqerise mund te rrise kapitalin e shoqerise dhe ta pasqyroje ate ne regjistrin tregetar.

#### NENI 18

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare,perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj,por gjithmone ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale dhe pasurore.Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

#### NENI 19

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

Shoqeria disponon mjetet e veta financiare.Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fondit rezerve ,nga fondet e tjera ose nga shumet suplementare qe kur deshiron mund te derdhen prej ortakut te vetem te saj ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese.

## KREU III

### VITI FINANCIAR,LLOGARITE VJETORE,NDARJA E FITIMIT.


#### NENI 20

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar ka fillim me ditën e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon me 31 dhjetor te vitit.

#### NENI 21

Llogarite vjetore,inventari,raportet e operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga



eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga asambleja e shoqerise. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda nje afati prej gjashte muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

#### N E N I 22

Fitimi neto realizohet nga shoqeria mbasi te zbriten te gjitha detyrimet si dhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike per investime per reklamen tregetare etj. Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Ne cdo peridhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabel te shoqerise me llogarine fitim humbje mbeshtetur ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private te percaktuara nga organet kopetente te sistemit fiskal.

#### N E N I 23

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes. Bilanci kontabel vjetor i shoqerise miratohet nga ortaku i vetem i cili vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin dhe garancine e veprimtarise se shoqerise.

### K R E U IV

#### ADMINISTRIMI

#### N E N I 24

Ortaku i vetem i shoqerise perballon humbjet e saj deri ne kufirine vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar te saj. Ortaku i vetem mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri, prej tij ne Kapital Themeltar.

#### N E N I 25

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar eshte prone e themeluesit te saj, ajo merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti, te cilat jane te detyrueshme per te gjitha punonjesit e shoqerise.

#### N E N I 26

Ortaku i vetem sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e shoqerise emerion administrator si dhe puneson punonjes te veprimtarive te ndryshme ekonomike sipas objektit te veprimtarise ekonomike te shoqerise.

#### N E N I 27

Ortaku i vetem shoqerise dhe administratori i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloj kufizimi. Ata kane mundesi te kryejne te gjitha aktet qe i konsiderojne te nevojshme per arritjen e qellimeve te shoqerise. Ata kane te drejte midis te tjerash te blejne e kembejne pasuri, telidhen me shoqerite e tjera te vendit ose te huaja, te kryejne cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave private ose

shteterore qe kane te bejne me garancite ,ipotekat dhe veprimtarine ekonomike dhe financiare te shoqerise etj.Ortaku i vetem i shoqerise dhe administratori i caktuar prej tij kane te drejte te kryejne prane institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi ,kreditimi,pagesa dhe arketime .Ne keto raste administratori i ngarkuar ka per detyre te ngarkoje,te njoftoje e t'i jape llogari ortakut te vetem.

#### NENI 28

Perfaqsimi i shoqerise i perket ortakut te vetem dhe administratorit te ngarkuar .Ata kane te drejten e perfaqsimet te shoqerise ne Organet gjyqesore dhe administrative ,te caktoje dhe te pushoje avokat.

### KREU V

#### KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

#### NENI 29

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe.Shoqeria mund te ndryshoje emerine,seline si dhe objektine veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre ortakut i vetem i saj.

### KREU VI

#### MARREDHENIET E PUNES

#### NENI 30

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me aktine themelimit per krijimin e shoqerise,legjislacionin shqiptar dhe me kete statut.

#### NENI 31

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes,puna e nates,puna jashte kohes normale,puna ne ditet e pushimit javor dhe festave zyrtare .

Mbrojtaj ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat,te drejtat,detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes,

Paga e punes se punonjesit,shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Marredhenie te tjera te punes rregullohen ne baze te Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise.

#### NENI 32

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

N E N I 33

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mundte lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata.

K R E U VII

## M B Y L L J A E S H O Q E R I S E

N E N I 34

Shperberja ose mbyllja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak si humbja e kapitalit, pamundesi veprimtarie etj. Ne keto raste ortakut i vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore. Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo ka ndaj personave te trete fizike dhe juridike. Shoqeria i jep fund veprimtarise ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit te hartuar nga likujdoret dhe ekspertet e miratuar.

K R E U VIII

## D I S P O Z I T A T E F U N D I T

N E N I 35

Te gjitha vendimet e shoqerise regjistrohen ne nje liber te vecante qe mbahet ne seline e shoqerise.

N E N I 36

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve nga ortakut i vetem dhe ligjeve perkatese shqiptare

N E N I 37

Ky statut perpilohet ne pese kopje te njejta origjinale per tju shperndare organeve kompetente ndersa nje kopje mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te shoqerise.

ORTAKU DHE ADMINISTRATORI I VETEM  
I SHOQERISE "FRUTBEST" SH.P.K.

Murat Halili

